

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 61/2012 ‘PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përgatitja e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”, është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1 dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe propozohet në kuadër të paketës fiskale 2022.

Konsolidimi i financave publike, rritja e të hyrave të buxhetit dhe ulja graduale e defiçitit buxhetor dhe borxhit publik për vitet në vijim, do mbështeten krahas masave të tjera edhe nga hartimi dhe miratimi i një Strategjie Afatmesme e të Ardhurave, e cila mbështetet në dy shtylla kryesore:

- i. rishikimi i politikave tatimore, duke korigjuar përjashtimet dhe tarifatat e reduktuara dhe joefektive, dhe
- ii. përmirësimi i administrimit tatimor, nëpërmjet zbatimit të procesit të fiskalizimit. Implementimi i kësaj Strategjie do bëjë të mundur rritjen e mobilizimit të të ardhurave tatimore shtesë në buxhet, duke patur një sistem tatimor neutral që shmang deformimet, të thjeshtë, eficient dhe të lehtë për tu zbatuar nga tatimpaguesit.

Në këtë kuadër, propozohen edhe disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, nëpërmjet projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”. Qëllimi i propozimeve është konsolidimi i të ardhurave nga akciza, nëpërmjet përafrimit të tyre gradual me nivelin e akcizave të parashikuara në Direktivën e BE-së, si dhe moslejimin e hapsirave ligjore për shmangie nga pagesa e akcizës, duke shfrytëzuar shkallët e diferencuara të saj për përdorues të ndryshëm.

Ky projektligj propozon masa të politikës fiskale në rishikimin e normave të niveleve të akcizës së disa produkteve, si dhe disa rregullime proceduriale të nevojshme për administrimin nga autoriteti doganor për të qënë në përputhje edhe me dispozitat e Kodit Doganor.

Këto ndryshime konsistojnë në sa më poshtë:

- Ndryshimin e nivelit të akcizës për Duhanin dhe nënproduktet e tij.
- Unifikimin e akcizës për “*Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike*”.
- Indeksimin e nivelit të akcizës bazuar në indeksin e rritjes së çmimeve.
- Heqja e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse për industrinë, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë (farmaceutika, tullat, çimento, birra dhe nafta bruto).
- Unifikim i procedurave dhe penalteteve me dispozitat e ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2021.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT VENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Strategjia Afatmesme e të Ardhurave shërben si një pikë kyçe për orientimin e vendimmarrjes në lidhje me forcimin dhe rritjen e përqindjes së të ardhurave që mblihen në raport me Produktin e Brendshëm Bruto. Objektivi i SAA-së është rritja e qëndrueshme e të ardhurave, në raport me PBB-në, nga të cilat 50% pritet të gjenerohen si rezultat i masave që do të ndërmerren në fushën e politikave fiskale dhe pjesa tjetër nga reformat e ndërmarra në fushën e administrimit tatimor dhe investimeve në teknologji, për periudhën afatmesme 2022-2025. Ndërkohë që, politikat fiskale të mirë dizenuara do luajnë rol të rëndësishëm në konsolidimin e financave publike, rritjen e të ardhurave dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”, vjen edhe si domosdoshmëri për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë të Bashkimit Evropian. Me anë të kësaj politike duke rritur akcizën për disa kategori të produkteve të akcizueshme pritet që impakti të jetë pozitiv në:

- Rritjen e të ardhurave të buxhetit të shtetit, përkthyer kjo në më shumë investime publike.

- Uljen e konsumit të duhanit me qëllim mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve nga pasojat negative që sjell ky produkt në shëndetin e tyre.
 - Krijimin dhe konsolidimin e një tregu stabël (pa oshilacione e të papritura), gjë që kufizon zhvillimin dhe rritjen e informalitetit në tregun e duhanit.
 - Minimizimin e hapsirave ligjore për shmangien nga pagesa e akcizës për gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike.
 - Reflektimin e rritjes së indeksit të çmimeve të konsumit të mallrave, mbi nivelin e akcizës që aplikohet mbi produktet e akcizueshme.
 - Përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian.
- Me anë të këtij projektligji propozohet heqja e rimbursimit për lëndët djegëse të konsumuara në serat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë (farmaceutika, tullat, çimeto, birra dhe nafta bruto). Aktualisht, ligji nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka parashikuar rimbursimin për lëndët djegëse të konsumuara në serat me ngrohje, për industrinë dhe agroindustrinë. Konkretisht, nga të dhënat rezulton se, nga kjo skemë rimbursimi ka përfituar vetëm industria, pasi për agroindustrinë nuk ka gjetur zbatim, si rezultat i mos kërkesës së subjekteve për të përfituar nga ky rimbursim. Sipas të dhënave, janë 11 subjekte përfituese nga kjo skemë rimbursimi për vitet 2020-2021, të cilët rezultojnë të jenë pjesë e industrisë hidrokarbure, tullave dhe farmaceutike.
- Ky propozim vjen në kuadër të hartimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, ku Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), ka rekomanduar që të gjitha përjashtimet jo standarde, normat e reduktuara dhe trajtimet preferenciale duhet të eliminohen nga TVSH-ja, akcizat dhe taksat kombëtare. Konkretisht, sipas rekomandimit të FMN-së, akciza e karburantit duhet të paguhet për të gjithë kaburantin e përdorur në ekonominë e vendit. Efekti i parashikuar në buxhetin e shtetit është +800 milion lekë.
- Projektligji ka parashikuar gjithashtu, detyrimin për indeksimin automatik të tarifave specifike të akcizës së mallrave në ligj. Ligji shqiptar ka parashikuar aplikimin e tarifave specifike të akcizës për çdo kategori malli të akcizueshëm. Ndryshe nga tatimi mbi vlerën e shtuar që është një tatim *ad valorem*, aplikimi i tarifave specifike në rastin e akcizës, nuk reflekton rritjen e indeksit të çmimeve të konsumit të mallrave, mbi nivelin e akcizës që aplikohet. Normat specifike të akcizave duhet të përditësohen sipas një baze të rregullt, me qëllim parandalimin e erozionit në akciza. Për këtë qëllim, duke filluar nga viti 2022, mbi tarifatat specifike të akcizës për mallra të ndryshme, do të aplikohet çdo vit rritja në vlerë absolute, e cila merr në

konsideratë rritjen e indeksit të çmimeve në përqindje të vitit paraardhës. Duke patur parasysh se indeksi vjetor i çmimeve në 10 vitet e fundit është rritur mesatarisht 1.5% - 2.2%, me këtë përqindje parashikohet të rriten edhe nivelet e akcizave të mallrave të akcizueshme, me përjashtim të grupit të duhaneve për të cilat është parashikuar rritje specifike në 5 vitet e ardhshme. Ky propozim vjen në kuadër të hartimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, ku Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), ka rekomanduar që në ligjin e akcizës të përfshihet detyrimi për indeksimin automatik të tarifave specifike të akcizës se mallrave.

Nga indeksi automatik vjetor i tarifave specifike të akcizës se mallrave të akcizueshme, pritet që të ardhurat nga akciza të rriten + 500 milion lekë.

- Një tjetër propozim i projektligjit ka të bëjë me ndryshime të cilat kanë qëllim heqjen e mbikëqyrjes së detyruar me prezencë fizike të autoriteteve doganore në procesin e vendosjes së pullave të akcizës, siç parashikohet aktualisht në nenin 41 të ligjit nr. 61/2012 dhe zëvendësimin e tyre me anë të mbikëqyrjes së tyre me kamera, duke lënë mundësinë që autoriteti doganor kur e vlerëson të arsyeshme të ushtrojë edhe prezencën fizike. Ky ndryshim synon të intensifikojë eficientësinë e personelit doganor në mbikëqyrje të proceseve të tjera përveç atij të vendosjes së pullave të akcizës. Ndryshimi i këtij neni, i jep autoriteteve doganore mundësinë e mbikëqyrjes nëpërmjet vendosjes së kamerave apo pajisjeve monitoruese brenda ambienteve të magazinave fiskale të stokimit si dhe magazinave doganore. Në të dyja rastet, nuk kemi risk të shtuar për vetë faktin e mbulimit me garanci të plotë 100% të detyrimeve të akcizës në mënyrë të dyfishtë, nëpërmjet garancisë së magazinës fiskale dhe të garancisë që parashikon ligji në momentin e porositjes së pullave fiskale. Statistikat e mëposhtëme tregojnë situatën me magazinat dhe stafin në doganën e Tiranës:

Dogana Tiranë	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Numër Magazinash pullosje	14	28	28
Numër Doganierëve	8	4	9
Numër magazinash Gjithsej	119	133	138

- Unifikimin e akcizës për “*Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike*”.

Është parashikuar shfuqizimi i pikës 3 të nenit 51 “Produktet që paguajnë akcizë”, të ligjit, ky ndryshim vjen si nevojshmëri e rregullimit të dispozitës në të njëjtën linjë me ndryshimet e bëra në shtojcën nr. 1 që i bashkëlidhet këtij projektligji lidhur me unifikimin e akcizës për “*Gazet e naftës dhe hidrokarbure*”.

të tjera gazoike”. Tashmë të gjithë konsumatorët do të kenë të njëjtin nivel taksimi (si për përdorim vetjak ashtu dhe për qëllime biznesi).

Nga unifikimi i akcizës për gazet e naftës dhe hidrokarburet e tjera gazoike në nivelin 6 lekë/litri pritet që të arkëtohen rreth +375 milion lekë akcizë në vit.

- Një pikë tjetër e projektligjit ka për qëllim të bëjë disa saktësime/rregullime në nenin 90 të ligjit nr. 61/2012. Saktësimin/korrigjimin kudo ku përmendet fjala “diferenca - mangësi apo tepricë” ‘2 për qind’ në nenin 90 të plotësohet me shprehjen pasuese ‘të sasisë kontabël të llogaritur për periudhën ushtrimore objekt kontrolli’. Definimi i 2% në rastet e zbatimit të penalitetit për mangësi ose tepricat në magazinat fiskale do të jetë kështu i mirëpërcaktuar dhe jo evaziv apo subjektiv në varësi të gjykimit të grupit të kontrollit dhe do të llogaritet mbi një sasi e cila llogaritet nga të dhënat e disponueshme të sistemit të deklarimit online EMCS, duke e saktësuar vetëm për sasinë kontabël në ditën objekt kontrolli dhe jo për të gjithë periudhën. Njëkohësisht, shtesa e togfjalëshit “Në rastet e produkteve të denatyrara”, në pikën 4 të nenit 90 të ligjit, sipas këtij projektligji, synon të specifikojë pikën 4 të nenit 90, e cila është në vijim të ndryshimit të mësipërm në ligjin 61/2012, duke ju referuar kështu tepricave në produktet e denatyrara, me qëllim që të shtohet kontrolli edhe për produktet e denatyrara. Kjo shtesë vjen si korrigjim i një gabimi sintaksor gjatë hartimit të këtij neni, duke lënë jashtë kontrollit produktet e denatyrara. Ndryshimi i parashikuar në pikën 8 të këtij neni të ligjit, synon të korrigjojë një mospërputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 86 të ligjit 61/2012, sipas të cilës përcaktohet se penalitetet për të gjitha shkeljet e kryera me produktet e akcizës gjatë procedurës së importit, eksportit, tranzitimit rregullohen sipas Kodit Doganor. Ndërkohë, sipas pikës 8 të nenit 90, përcaktohen penaliteti për diferenca të konstatuara në cilësi ose në sasi të produkteve, që i nënshtrohen akcizës duke përfshirë dhe produktet e destinuara për eksport, ku në fakt sipas pikës 1 të nenit 86 të sipërcituar, penalitetet për eksportet përcaktohen sipas Kodit Doganor. Gjithashtu, ndryshimi i pikës 10 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohen masat/penalitetet për tepricat mangësit në pulla fiskale, që konstatohen gjatë kontrollit të magazinave fiskale, duke i ndëshkuar si diferencë në produkte akcize të konvertuara në sasi të përkatëse, synon unifikimin e penaliteteve të këtij ligji me nenin 259 të ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit masa e gjobës varjon nga 20 000 lekë deri në 50 000 lekë. Me këtë propozim synohet edhe evitimi i vendosjes dy herë të të njëjtit penalitet për shkelje të të njëjtës natyrë, një herë për teprica apo mangësi të konstatuara për produktet e akcizës dhe një herë si konstatim i tepricës apo mangësisë së pullave fiskale.

Kjo masë nuk ka efekte në të ardhura.

- Me anë të këtij projektligji propozohet zbutja e gjobës për rastet e mosmbajtjes së regjistrave të parashikuar në nenin 92 të ligjit nr. 61/2012, pasi mbajtja e regjistrave sipas kërkesave të legjislacionit të akcizës, aktualisht kryhet në sistemin elektronik Asycuda World. Sipas kërkesave të legjislacionit të akcizës, parashikohet që përveç sistemit elektronik edhe mbajtja e regjistrave manuale. Nisur nga fakti që një subjekt mban regjistrime elektronike (që verifikohen në çdo kohë nga autoriteti doganor), synohet të zbutet masa e penaltetit për mosmbajtje të regjistrave manuale pasi është shumë e lartë. Penalteti zbutet nga 500.000 lekë në 50.000 lekë. Kjo masë nuk ka efekte në të ardhura.
- Projektligji gjithashtu, synon të unifikojë/saktësojë masën e penalteteve lidhur me tepricat/mangësitë në qarkullimin e pullave fiskale që parashikohen në nenin 94/1 të ligjit nr. 61/2012, me parashikimet e dispozitave të ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Konkretisht, në rastin kur është depozitues i miratuar i nënshtrohet rregullimit të nenit 86 pika 2 e ligjit 61/2012, ndërkohë që kur nuk është depozitues i miratuar rregullohet sipas parashikimeve të dispozitave të shkronjës “b”, të nenit 259 të ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Aktualisht, sipas ligjit nr. 61/2012, masa e penaltetit për tepricat ose mangësitë në pullat fiskale mbi 2% të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve është me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës, që duhej paguar, kjo masë penaltetit propozohet të njësohet me përcaktimet e Kodit Doganor, ku masa e gjobës është 20 000 lekë deri në 50 000 lekë. Kjo masë nuk ka efekte në të ardhura.
- Është propozuar të korrigjohet një gabim, sa i takon produkteve të markuara në eksport, sikurse parashikohet aktualisht në nenin 95 të ligjit nr. 61/2012, duke qënë se nuk markohet produkt në eksport, për rrjedhojë është propozuar që fjala “eksportimi”, të hiqet nga paragrafi i parë i nenit 95 të ligjit. Gjithashtu, ky nen synon të saktësojë procesin e aplikimit të penalteteve për rastet e konstatuara FAIL, me qëllim aplikimin e detyrimeve dhe penalteteve vetëm për sasinë e konstatuara të pamarkuara. Ky rregullim shmang aplikimin e penaltetit për të gjithë sasinë në depozitë duke e specifikuar vetëm për sasinë e pamarkuar të identifikuar nëpërmjet analizave/testimit nga autoriteti doganor. Aktualisht në nenin 95, të ligjit nr.61/2012, përcaktohen penaltetet lidhur me produktet që markohen/shenjohen apo ngjyrosen të cilat konstatohen të pa markuara/shenjuara apo ngjyrosura në sasinë dhe përqendrimin e duhur gjatë kontrollit. Konkretisht sipas shkronjës a) të nenit 95, dënohen me gjobë për herë të parë të konstatuar, sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që

duhet të paguhet për të gjithë sasinë e produktit të gjendur në depozitë, për herë të dytë të konstatuar me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duhet të paguhet për të gjithë sasinë e produktit të gjendur në depozitë dhe për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duhet të paguhet për të gjithë sasinë e produktit të gjendur në depozitë. Ky lloj penalteti bën që masa e gjobës së aplikuar të jetë për të gjithë sasinë në depozitë dhe jo vetëm për sasinë e pamarkuar, sikurse duhet të jetë realisht, duke e ndarë këtë penaltet sipas ashpërsisë në bazë të herëve të konstatuara. Për rrjedhojë, duke qënë se me anë të këtij projektligji synohet që të ketë penaltete vetëm për sasinë e pamarkuar dhe jo të gjithë depozitën, është propozuar edhe ashpërsimi i penalteteve, ku për çdo rast të aplikohet gjobë prej 5-fish të detyrimeve të akcizës që duhen paguar.

- Me anë të këtij projektligji janë propozuar ndryshime sa i takon unifikimit të afateve të marrjes së vendimit dhe njoftimit të vendimit për konstatimet e kundërvajtjeve administrative në fushën e akcizave, duke i njëzuar me afatet e parashikuara në ligjin nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 97 “Verifikimi”, pika 4 e ligjit nr. 61/2012, afati për të drejtën e shkelësit për të paraqitur pretendimet e tij lidhur me vendimin e autoritetit doganor për shkelje, ndryshohet nga 5 ditë kalendarike në 10 ditë kalendarike me qëllim unifikimin me parashikimet e pikës 4 të nenit 273 ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në neni 99 “Marrja e njoftimit dhe vendimi”, pika 2, përse lidhet me vendimin e autoriteteve doganore për shkeljet e konstatuara afati nga 10 ditë kalendarike bëhet 60 ditë kalendarike, për tu njëzuar me parashikimet e pikës 4 të nenit 282 të ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në nenin 105 “Apelimi ndaj vendimeve të autoriteteve doganore për vendosjen e sanksioneve”, pika 4 e ligjit nr. 61/2012, afati i marrjes së vendimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave nga 30 ditë kalendarike bëhet 60 ditë kalendarike, duke u unifikuar me parashikimet e pikës 4 të nenit 282 të ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Gjithashtu, është ndryshuar përmbajtja e pikës 6 e nenit 105 të ligjit 61/2012, me qëllim që të njësohet afatin për apelimin ndaj vendimeve të autoriteteve doganore nga 30 ditë në 45 ditë kalendarike, sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 282 të ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

- Me anë të këtij projektligji është propozuar edhe zëvendësimi i Shtojcës nr. 1 të ligjit nr. 61/2012, me Shtojcën nr.1 që i bashkëlidhet këtij projektligji. Është propozuar ndryshimi i nivelit të taksimit për të gjitha kategoritë e

produkteve të “Duhanit dhe nënprodukteve të tij”, si edhe unifikimin e akcizës për “Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike”.

Me miratimin me Ligj të një kalendar 5-vjeçar të rritjes graduale të akcizës (2017 - 2021), pati një reduktim të tregtisë së paligjshme si edhe një stabilizim të tregut dhe të të ardhurave, pasi operatorëve më të mëdhenj të tregut formal, por edhe organeve doganore, iu krijua siguri e mjaftueshme ligjore për furnizimin e konsumatorëve dhe realizimin e të ardhurave. Duke u nisur nga zbatimi i suksesshëm i kalendarit aktual si edhe nga stabiliteti i krijuar në ruajtjen dhe përmirësimin e formalitetit, në uljen graduale të konsumit, por edhe në rritjen graduale të të ardhurave, propozohet një kalendar i ri për periudhën vijuese 5-vjeçare 2022 – 2026, që bazohet në të njëjtat parime dhe objektiva.

Gjatë periudhës 2018-2021 akciza e cigareve u rrit çdo vit sipas një skeduli të parashikuar në ligj, konkretisht nga 5550 lekë/1000 fije në 5850 lekë/1000 fije më 1 janar 2018; 6000 lekë/1000 fije në 1 janar 2019; 6250 lekë/1000 fije në 1 janar 2020 dhe 6500 lekë/1000 fije në 1 janar 2021, siç është dhe aktualisht.

Në krahasim me vendet e rajonit, Shqipëria dhe Kosova aplikojnë vetëm akcizë mbi sasinë e jo mbi vlerën e cigareve, që nënkupton një taksim specifike dhe jo ad-volerem apo ndërthurje të këtyre dy formave të taksimit siç edhe aplikohet nga vendet e rajonit. Norma e akcizës së aplikuar është më e vogël, me përjashtim të Maqedonisë.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur niveli i taksimit për cigaret që përmbajnë duhan sipas vendeve të rajonit:

	2017			2018		2019		2020		2021	
	Ad valorem (% of retail sales price)	Specific (€ per 1000 sticks)	VAT rate (%)	Ad valorem (% of retail sales price)	Specific (€ per 1000 sticks)	Ad valorem (% of retail sales price)	Specific (€ per 1000 sticks)	Ad valorem (% of retail sales price)	Specific (€ per 1000 sticks)	Ad valorem (% of retail sales price)	Specific (€ per 1000 sticks)
Albania	0	46	20%	0	46	0	49	0	50	0	53
Kosova	0	45	18%	0	46	0	47	0	48	0	49
North Macedonia	9%	33,5	18%	9%	37	9%	40	9%	43	9%	46
Montenegro	32%	30	19%	32%	30	32%	30	31%	34	29%	37
Serbia	33%	29,5	20%	33%	31	33%	31	33%	32	33%	33

Arsyet për rritjen e nivelit të akcizës në produktet e duhanit:

1. Rritje graduale progresive për t'u përafuar me nivelin minimal, sipas Direktivës së BE-së 2011/64 “*On the structure and rates of excise duty applied to manufactured tobacco*”, e cila përcakton nivelin minimal të akcizës për cigaret, të paktën 90 euro/1000 fije.
2. Të garantohet një rritje graduale e të ardhurave nga akciza dhe TVSH.

3. Rritja e akcizës së cigareve si një instrument për rritjen e çmimit të shitjes së tyre dhe politikë fiskale që synon frenimin dhe uljen e konsumit të cigareve, si produkt me pasoja në shëndetin e pupullatës.
4. Ti jepet mundësi operatorëve formalë që të bëjnë plane biznesi afatgjatë dhe ti krijohet siguri në të bërit biznes;
5. Të garantohet një rritje graduale e çmimeve me pakicë që të ndikojë financiarisht tek konsumatorët, por jo ti orientojë drejt tregjeve të paligjshme;
6. Të mbrohen të ardhurat nga erozioni i mundshëm drejt kategorive të reja të produkteve të nikotinës si Shisha, Duhan me ngrohje, Qeska Nikotine për përdorim oral dhe cigare elektronike (me lëng).

Ndërkohë, është e rëndësishme të theksojmë se rritja e nivelit të akcizës së duhaneve dhe masa e rritjes e parashikuar në vite, duhet të jetë e balancuar dhe neutrale ndaj nivelit të akcizave në vendet e rajonit, me qëllim që të mos nxisë fenomenet e shmangies së akcizës dhe kondrbandës ndërkufitare me mallrat e akcizës.

Në këtë kuadër është propozuar kalendar rritjeje për të gjithë kategoritë e “Duhan dhe nënprodukteve të tij”. Është shtuar një kategori e re T403 “Shisha, nargjile” me kod 240311 dhe nivel akcize 6750 lekë/kg, nga 1 janari 2022 duke u rritur më pas për 4 vitet në vijim me 500 lekë/kg nderkohe per kete kategori per nargjilenë me duhan të kultivuar ne Shqipëri propozohet niveli 2500 lekë/kg, nga 1 janari 2022 dhe rritje me 250 leke/kg cdo vit. Në kategorinë T401 “*Nikotinë lëng*” është propozuar të shtohet nëndarja me përshkrim “*Qeska Nikotine – Duhan i prodhuar dhe produkte nikotine me aplikim oral pa djegie*”, me nivel akcizë 6750 lekë/kg, duke u rritur më pas për 4 vitet në vijim me 500 lekë/kg.

Nëpërmjet këtij ndryshimi synohet të kemi një taksim të drejtë me akcizë për produktin nargjile, i cili pas përpunimit të tij, ka në përmbajtjen e produktit 10 apo 15% “duhan”, por që aktualisht taksohet sikur e gjithë përbërja të ishte prej duhani. Ky propozim vjen i bazuar me frymën e ligjit 61/2012, që akciza paguhet vetëm për sasinë e produktit të akcizës (psh Birra, pijet alkolike bazuar në % e alkolit, duhani me ngrohje bazuar në sasinë e duhanit në produkt), si edhe për mbrojtjen e të ardhurave nga erozioni i mundshëm i konsumit drejt produkteve të reja.

Arsyeja për detajimin e kësaj kategorie në listën e mallrave të akcizës është se në tregun vendas po tregtohet gjerësisht ky produkt me një trend në rritje të bareve dhe klubeve që ofrojnë këtë lloj produkti. Sipas të dhënave një sasi tepër e vogël është rregjistruar, pajisur me pullat përkatëse të akcizës dhe rrjedhimisht zhdoganuar. Aplikimi i akcizës për këtë produkt, në vendet të cilat e tregtojnë, është i ndryshëm, por duke mbizotëruar taksimi në kg të sasisë së duhanit brenda paketimit. Lidhur me klasifikimin dhe taksimin e këtij produkti është

propozuar të jetë në nivelin 6,750 lekë/kg dhe baza e llogaritjes të jetë e bazuar në peshën e duhanit neto në produkt.

Për dy kategoritë e mësipërme, për nikotinën lëng dhe shisha nargjile, por edhe për duhanin me ngrohje është propozuar një nivel taksimi me rritje më të shpejtë duke pasur parasysh se këto produkte dhe pse akoma zënë një peshë të vogël në total të ardhurat nga akciza (më pak se 5%), pritet të kenë një tendencë rritje në të ardhmen e afërt, duke cënuar të ardhurat afatmesme nga akciza.

Rritja e akcizës së cigareve që përmbajnë duhan në vendin tonë ka qenë graduale ndër vite me qëllim përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Direktiva e BE-së parashikon që niveli i akcizës duhet të jetë jo më i ulët se 90 Euro/1000 fije e shprehur në lekë (11.250 lekë/1000 fije) nga 6500 lekë/1000 fije që është aktualisht.

Niveli aktual i akcizës së cigareve prej 6500 lekë/1000 cope, është larg nivelit minimal të parashikuar në Direktivë. Për këtë qëllim dhe me synimin për tju afruar gradualisht nivelit të Direktivës, nëpërmjet këtij projektligji është parashikuar rritja e nivelit të akcizës në 5 vitet e ardhshme me 5 lekë për paketë sipas këtij kalendari i cili shprehet në fije jo paketë:

6750 lekë/1000 fije duke filluar nga 1 janari 2022;

7000 lekë/1000 fije duke filluar nga 1 janari 2023;

7250 lekë/1000 fije duke filluar nga 1 janari 2024;

7500 lekë/1000 fije duke filluar nga 1 janari 2025;

7750 lekë/1000 fije duke filluar nga 1 janari 2026.

Nga rritja e akcizës në grupin e duhaneve, parashikohet efekt vjetor në rritjen e të ardhurave nga akciza rreth +750 milion lekë.

➤ Projektligji parashikon aplikimin e shkallës së taksimit me akcizë 6 lekë/litri për gazet e naftës dhe hidrokarburet e tjera gazoike. Aktualisht niveli i akcizës për këtë nënprodukt është 8 lekë/litri nëse ai përdoret si lëndë djegëse për automjetet, ndërkohë që pjesa e këtij produkti që përdoret nga konsumatorët e tjerë, qoftë për qëllime industriale apo konsumi familjar nuk ngarkohet me akcizë.

Projektligji, synon të vendosë një nivel akcize për gazin e lëngshëm pa diferencuar qëllimin e përdorimit, pasi siç është formuluar ligji aktualisht jep mundësinë e abuzivizmit me sasinë e gazit që nuk paguan akcizë. Pas më shumë se një viti kontrollesh në zinxhirin e plotë të tregëtimit të gazit, është konstatuar se unifikimi është e vetmja zgjidhje për uljen e evazionit në treg. Nga sasia e importuar e kësaj lënde djegëse, rreth 2/3 nuk ngarkohet me akcizë, që presupozon se nuk përdoret si karburant për automjetet, ndërkohë që vetëm 1/3 e sasisë së importuar deklarohet për përdorim automjetesh dhe ngarkohet me akcizë. Përvoja disa vjeçare ka treguar se administrimi i deklarimit të

destinacionit të përdorimit të këtij nënprodukti është shumë i vështirë, duke krijuar mundësi për shmangie nga pagesa e akcizës. Për këtë qëllim është i domosdoshëm unifikimi i nivelit të akcizës për të gjithë përdoruesit. Ky unifikim ul nivelin e akcizës nga 8 /lekë/litri në 6 lekë/litri duke ulur edhe koston e përdoruesve të mjeteve motorrike, ndërkohë që rritja e akcizës për përdoruesit e tjerë industrialë dhe familjarë me 6 lekë/litri vërtet do të rrisë koston e përdorimit të kësaj lënde nga ata, por në kushtet kur diferencimi i akcizës lejon shmangien dhe mospagesën e saj, avantazhet krahasuese janë në favor të unifikimit të nivelit të akcizës.

Nga unifikimi i akcizës për gazet e naftës dhe hidrokarburet e tjera gazoike në nivelin 6 lekë/litri pritet që të arkëtohen rreth +375 milion lekë akcizë në vit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1 dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”, synon të përafrojë ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me akte të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur me Direktivën 2011/64/BE është e pjesshme.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 12 nene, të cilat konsistojnë në shtesa dhe ndryshime të dispozitave përkatëse të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si më poshtë:

Në nenin 1 parashikohet se, në nenin 14 “Rimbursimi”, shkronja (d) shfuqizohet.

Në nenin 2 parashikohet që, në nenin 18 “Mënyra e llogaritjes”, pas pikës 2 të shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Akciza e llogaritur në njësinë matëse sipas seksioneve respektive dhe sipas shtojcës nr. 1 të këtij ligji, indeksohet çdo dy vjet bazuar në normën e shpallur të inflacionit për dy vitet paraardhëse, me përjashtim të duhanit dhe

nënprodukteve të tij, për të cilat akciza do të aplikohet sipas kalendarit të përcaktuar në shtojcën nr.1 që i bashkëlidhet ligjit. Në vitin 2022, akciza indeksohet me normën e shpallur të inflacionit të vitit 2020 plus normën e rezultuar të shpallur të inflacionit deri në fund të 9 mujorit të vitit 2021.”.

Në nenin 3, është parashikuar që, në nenin 41 “Aplikimi i pullave fiskale”, pika 8, shkronja (ç) paragrafi *“për sigurimin e pranisë së autoriteteve doganore gjatë procesit të vendosjes së pullave. Procesi i vendosjes së pullave fiskale fillon pas sigurimit të prezencës së autoriteteve doganore. Në përfundim të procesit hartohet procesverbali përkatës, në të cilin pasqyrohen të gjitha të dhënat, në lidhje me pullat e vendosura, si dhe nënshkruhet nga përfaqësuesi i autoriteteve doganore dhe depozituesi i miratuar.”*, të ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“Për mbikqyrjen e procesit të vendosjes së pullave, autoritetet doganore kompetente, i kërkojnë operatorëve të autorizuar të marrin masa për të siguruar mbikqyrje nëpërmjet vendosjes së kamerave, paraqitjes së rakordimeve për çdo proces pullosje, si dhe njoftimit paraprak 3 ditë përpara zhvillimit të procesit. Në çdo rast që e konsideron të arsyeshëm, autoriteti doganor kompetent mund të sigurojë prezencën e tij dhe mbikqyrje të procesit.”

Në nenin 4 është parashikuar shfuqizimi i pikës 3 të nenit 51 “Produktet që paguajnë akcizë”.

Në nenin 5, përcaktohet që në nenin 90, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- Në pikën 1 deri në pikën 5 të tij, kudo ku përmendet “2 për qind” të zëvendësohet me *“2 për qind të sasisë kontabël të llogaritur për periudhën objekt kontrolli”*.

- Në pikën 4 në fillim të fjalisë shtohet togfjalëshi *“Në rastet e produkteve të denaturuara”*.

- Në pikën 8, hiqet shprehja *“të destinuara për eksport”*.

- Pika 10, të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Tepricat ose mangësitë në pulla fiskale, të konstatuara gjatë kontrollit të magazinave fiskale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë nga 20.000 lekë deri në 50.000 lekë në varësi të rasteve të përsëritura. Pagesa e gjobës, në asnjë rast nuk shmang shkelësin nga pagimi i detyrimit të munguar të akcizes, për sasinë e pullave me diferencë”.

Në nenin 6 përcaktohet se, në nenin 92 shprehja “500.000 lekë” zëvendësohet me shprehjen “50.000 lekë”.

Në neni 7 parashikohet që neni 94/1, të ndryshojë më përmbajtje si më poshtë vijon:

“Shkeljet në qarkullim të pullave fiskale.

Tepricat ose mangësitë në pullat fiskale mbi 2 % të sasisë kontabël të llogaritur për periudhën objekt kontrolli’, të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomikë të cilët nuk janë depozitues të miratuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në përputhje me përcaktimet e shkronjës “b”, të nenit 259 të Ligjit Nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar. Pagesa e gjobës në asnjë rast nuk shmang shkelësin nga pagimi i detyrimit të munguar të akcizes, për sasinë e pullave me diferencë”.

Në nenin 8, përcaktohet se, në nenin 95 të ligjit 61/2012, paragrafi i parë, fjala “eksportim”, të hiqet.

-shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) Në çdo rast të konstatuar, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar për sasinë e produktit të gjendur të pa markuar/shenjuar apo ngjyrosur, bazuar në rezultatet e analizimit/testimit.”.

Në neni 9, përcaktohet se, në nenin 97, pika 4, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“4. Në rast se konstatimi i shkeljes, sipas këtij ligji, bëhet a posteriori nga strukturat doganore kompetente ose nga struktura të tjera hierarkike doganore apo të kontrollit, sipas legjislacionit në fuqi, kopja e procesverbalit të nënshkruar nga punonjësit doganorë apo përfaqësuesit e strukturave kontrolluese, që ushtruan verifikimin dhe kontrollin, i njoftohet shkelësit nga autoriteti doganor kompetent brenda 5 ditëve kalendarike. Në procesverbal përcaktohet edhe e drejta e shkelësit për të paraqitur pretendimet e tij me shkrim, brenda 10 ditëve kalendarike, pranë autoriteteve doganore kompetente.”.

Në neni 10, përcaktohet se:

-Në nenin 99, pika 2, përcaktimi “brenda 10 ditëve” ndryshohet në “brenda 60 ditëve”.

-Në nenin 105, pika 4, përcaktimi “brenda 30 ditëve” ndryshohet në “brenda 60 ditëve”

-Në nenin 105, pika 6, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“6. Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, ankimuesi mund të ankohet pranë autoriteteve gjyqësore brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të mospranimit të ankesës, ose brenda 45 ditëve nga mbarimi i afatit të shqyrtimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni.”

Në neni 11 parashikon se, shtojca nr.1, “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohet me Shtojcën nr.1 “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, që i bashkëlidhet këtij projektligji.

Në neni 12, është parashikuar botimi i këtij projektligji në Fletore Zyrtare dhe shtrirja e efekteve të tij nga data 1 janar 2022.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij akti, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE I SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet në buxhetin e shtetit nga parashikimet e këtij projektligji vlerësohen pozitive, përafërsisht në masën +750 milion lekë nga skeduli i ri akcizës për duhanet, +375 milion lekë nga unifikimi i akcizës së gazit të lëngshëm, +800 milion nga heqja e rimbursimit për lëndët djegëse për fermerët dhe industrinë agroindustriale dhe +500 milion lekë nga indeksimi automatik vjetor i nivelit të akcizës.

KËSHILLI I MINISTRAVE